



BiEPAG

Dhjetor 2023

Politika e energjisë
së gjelbër:

AKTORËT E JASHTËM DHE TRANZICIONI I ENERJISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Autorë: Tena Prelec, Nikolaos Tzifakis, Dimitar Bechev

* Për projektin hulumtues

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (BiEPAG) realizoi një studim gjithëpërfshirës për gjeopolitikën e tranzicionit drejt energjisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Ky dokument politikash mbështetjet në gjetjet e dokumentit të parë "Energjia në Ballkanin Perëndimor" (maj 2023), në një sondazh të realizuar në nivel rajoni, puna në terren e të cillit u krye nga Kantar në pranverën e vitit 2023 në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe në analizën e tre rasteve të veçanta studimore nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova, me kontribute nga Marika Djolai, Donika Emini, Vujo Ilić, Zoran Neçev dhe Corina Stratulat. Rreth autorëve: Tena Prelec është Asistent-Profesore në Qendrën për Studime të Avancuara të Evropës Juglindore (CAS SEE), Universiteti i Rijekës; Nikolaos Tzifakis është Profesor në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (PSIR) në Universitetin e Peloponezit; dhe Dimitar Bechev është Lektor në Shkollën Globale të Oksfordit, Bashkëpunëtor Shkencor në Studime të Evropës dhe Zonës në Carnegie (OSGA), Universiteti i Oksfordit.

Abstrakt

Në dokumentin e fundit të BiEPAG për Gjeopolitikën e Tranzicionit të Energjisë së Gjelbër¹ trajtohet roli i BE-së në promovimin e tranzicionit të energjisë në Ballkanin Perëndimor. Pavarësisht angazhimit të BE-së për marrjen e masave me fokus klimën dhe nëpërmjet asistencës së konsiderueshme financiare, përparimi i rajonit drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë mbetet i ngadaltë. Studimi, i bazuar në një sondazh gjithëpërfshirës dhe në analizën e tre rasteve studimore për ndikimin e faktorëve të jashtëm në sektorin e energjisë, nxjerr në pah dëshirën e publikut për tranzicionin e gjelbër, por edhe mungesën e ndërgjegjësimit në lidhje me ndikimin negativ të aktorëve të jashtëm si Rusia, Kina dhe Turqia. Në analizë theksohet roli vendimtar i elitave vendore në zbutjen e ndikimit të huaj dhe evidentohen pabarazitë në perceptimet e publikut. Disa nga rekomandimet që jepen në këtë dokument janë realizimi i një fushate të posaçme të diplomacisë publike, mbështetja për aktorët e shoqërisë civile që mbrojnë kauzat e energjisë së gjelbër, diversifikimi i burimeve të energjisë, stimujt financiarë për liberalizimin e tregut, rritja e transparencës së investimeve të huaja si dhe bashkëpunimi rajonal për ndërlidhjen e rrjetit dhe investimet në energjinë e rinovueshme. Gjetjet theksojnë nevojën për marrjen e masave për politika më të rafinuara për të siguruar një tranzicion të qëndrueshëm dhe të drejtë të energjisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor.

1 "Gjeopolitika e Tranzicionit drejt Energjisë së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor", Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (BiEPAG), 2023. <https://biepag.eu/geopolitics-and-energy-transition/>

I. A mund të jetë BE “udhëheqës i gjelbër” në Ballkan?

BE e sheh veten si lider botëror në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe në promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Këto objektiva jo vetëm që respektohen nga vendet anëtare, por formësojnë tërësisht marrëdhëniet e Unionit me botën e jashtme. Edhe pse mund të ketë shumë fusha ku vendet anëtare të BE-së nuk janë dakord me njëra-tjetrën, ato janë të bashkuara në përpjekjet për uljen e emetimeve të gazeve serrë në botë. Kjo ambicie nuk është në asnjë vend më e dukshme sesa në vendet fqinje të BE-së. Për më shumë se një dekadë, Brukseli ka ecur përpara me reformat në tregun e energjisë, të orientuara drejt rritjes së efikasitetit, uljes së çmimeve për konsumatorët dhe sigurimit të vazhdimësisë së furnizimit me energji. Ballkani Perëndimor, krahas vendeve kandidatë në Evropën Lindore si Moldavia dhe Ukraina, kanë qenë objektivi kryesor i kësaj politike.

Në vitet e fundit, fokusi është zhvendosur nga siguri i energjisë drejt politikës për klimën. Udhëheqësit e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor – Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Shqipëria – u zotuan në një mbledhje në nëntor 2020 nën kujdesin e Procesit të Berlinit të mbështetur nga BE se “do të angazhohen për të punuar drejt objektivit 2050 për një kontinent neutral ndaj karbonit së bashku me BE-në përmes integritit të një politike të posaçme për klimën dhe reformimin e sektorëve të energjisë dhe transportit”.² Komuniteti i Energjisë, një platformë bashkëpunimi rajonal të mbështetur nga BE ka përcaktuar objektiva që deri në vitin 2030, 31% e konsumit fundor bruto të energjisë duhet të vijë nga burimet e rinovueshme, konsumi i energjisë duhet të kufizohet, dhe emetimet e gazeve serrë duhet të reduktohen me mbi 60 % krahasuar me nivelet e viteve 1990.³ Edhe nga financimi i jashtëm nëpërmjet Instrumentit të BE-së për Asistencën e Para-Aderimit dhe Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, që është një partneritet midis BE-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, i jepet përparësi objektivave të gjelbra.

Fatkeqësisht, ecuria e Ballkanit Perëndimor drejt tranzicionit të gjelbër është e paqëndrueshme. Është arritur pak sukses në modernizimin e sektorit energjetik të rajonit ose në uljen e emetimeve. Në përgjithësi, vendet e Ballkanit Perëndimor mbeten të varura nga qymyri. Aktualisht, linjiti përbën rreth 70% të energjisë elektrike të prodhuar në rajon. Në Kosovë, Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë përqindja është përkatësisht 95%, 67% dhe 65%.⁴ Përveç kësaj, investimet e reja në këtë sektor janë të pakta. Moshë mesatare e flotës së linjtit, e cila përbën rreth gjysmën e

2 “Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans”, Sofia, 10 November 2020, <https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf>.

3 “Decision of the Ministerial Council of the Energy Community”, Energy Community, No 2022/02/MC-EnC, Vienna, 12 December 2022, https://www.energy-community.org/dam/jcr:421f0dca-1b16-4bb5-af86-067bc35fe073/Decision_02-2022-MC_CEP_2030targets_15122022.pdf.

4 Ruiz, P., Medarac, H., Somers, J. and Mandras, G., “Recent Trends in Coal and Peat Regions in the Western Balkans and Ukraine”, EUR 30837 EN, Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2021, p. 4.

kapacitetit gjenerues dhe më shumë në prodhim, është mbi 40 vjeçare⁵ dhe sistemet e energjisë elektrike të disa vendeve kanë qenë afër kolapsit gjatë dimrave të fundit. Termocentralet e qymyrit rritin emetimet e gazeve serrë, por nga ana tjetër janë edhe një nga shkaqet e cilësisë së dobët të ajrit dhe kanë ndikim mjaft negativ në shëndet.⁶

Ngërçi në terren po shfrytëzohet nga aktorë të jashtëm gjeopolitikë, përfshirë këtu Rusinë, Kinën dhe Turqinë, që kanë krijuar sferat e tyre të influencës në sektorët politikë, ekonomikë dhe energjetikë të rajonit. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor e kanë pranuar këtë me shpresën për të krijuar vende të reja pune, për të vjelë dhe rishpërndarë qiratë për klientelën e tyre politike dhe për të mbajtur në nivel të ulët çmimet e energjisë për popullatën në përgjithësi. Ndërkohë, BE po bën përpjekje për të promovuar përmbushjen e standardeve në vendet ku mungon vullneti politik ose ku kapacitetet shtetërore për të zbatuar politika publike ambicioze janë të pamjaftueshme.

Sipas një hulumtimi të perceptimit të popullsisë në rajon, në këtë studim del në pah se publiku i Ballkanit Perëndimor mbështet tranzicionin e gjelbër, por nuk e vlerëson plotësisht kontributin e BE-së për arritjen e këtij qëllimi. Përveç kësaj, publiku nuk arrin të dallojë ndikimin negativ të disa investimeve të huaja në sektorin energjetik të rajonit. Thënë kjo, duhet të shmangim gabimin e hedhjes së pjesës më të madhe të fajit për ritmin e ngadaltë të tranzicionit të energjisë tek investitorët e huaj. Duke u bazuar në punën në terren dhe një sërë intervistash me aktorët e interesit në sektorët energjetikë të Serbisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Kosovës, ekspertë të BiEPAG argumentojmë se përgjegjësia kryesore për mungesën e progresit qëndron tek qeveritë e këtyre vendeve. Studimi përfundon me një sërë rekomandimesh për politika për të ndihmuar BE-në të kontribuojë në një tranzicion më efikas dhe më të drejtë energjetik në rajon.


5 Po aty, f. 5

6 Për një raport gjithëpërfshirës në lidhje me emetimet e rrezikshme të termocentraleve të qymyrit në Ballkanin Perëndimor, shih: "Plotëso standardet ose mbylle: Pesë vjet shkelje ligjore vdekjeprurëse nga termocentralet e qymyrit të Ballkanit Perëndimor", Rrjeti i EJK Bankwatch, qershor 2023, https://www.complyorclose.org/wp-content/uploads/2023/06/2023_06_28_Comply-or-close.pdf.

II. Perceptimi publik për tranzicionin e gjelbër


BiEPAG realizoi një sondazh të opinionit publik në rajon gjatë periudhës mars-prill 2023.⁷ Sondazhi tregoi se tranzicioni i gjelbër gëzon mbështetje të gjerë. Një shumicë dërrmuese prej 71% e të anketuarve në të gjithë Ballkanin Perëndimor besojnë se vendet e tyre duhet të marrin energji kryesisht nga burimet e rinovueshme deri në vitin 2050 (shih Grafikon 1). Po aq inkurajues është edhe konstatimi se një përqindje e ngjashme e pjesëmarrësve (67%) mbështesin rritjen e investimeve në burimet e rinovueshme brenda vendit si përgjigje ndaj krizës energjetike – gjë që evidenton se qytetarët mund të jenë të përgatitur të mbështesin një rritje të fondeve publike që përdoren për rritjen e aftësive prodhuese të energjisë së gjelbër.

Grafiku 1: Burimet nga të cilat duhet të marrin energji vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2050.





Këtu ka një paralajmërim. Kur të anketuarit u pyetën se çfarë i shqetësonte më shumë, pjesa më e madhe përmendën vështirësitë ekonomike (60%). Degradimi i mjedisit dhe ndryshimet klimatike nuk u konsideruan edhe aq të rëndësishme në këtë listë: këto çështje u përmendën vetëm nga 19% dhe 15% e të anketuarve

⁷ Sondazhi u krye nga Kantar, duke përdorur metodën CATI për mbledhjen e të dhënave CATI duke u bazuar në një kampion përfaqësues prej >1,000 të anketuarish për secilin vend të Ballkanit Perëndimor (kampioni në total N=6,047 vetë).

Grafiku 2: Problemet më shqetësuese

respektivisht (shih Grafikon 2). Kështu, nëse aktorët me interesa vetjake në ruajtjen e status quo-së do ta shisnin me sukses te publiku tranzicionin energjetik si një politikë të shtrenjtë që mund të kishte ndikim në popullatën e gjerë, mbështetja publike për burimet e rinovueshme mund të pësonte dëme serioze.


Të anketuarit ia ngarkuan përgjegjësinë kryesore për problemet mjedisore praktikave të energjisë në nivel shoqërie (71%) dhe politikave të shteteve (58%). Megjithatë, ata i dhanë përgjigje të ndryshme pyetjes nëse ndonjë aktor i jashtëm ushtronte ndikim negativ në zgjedhjet e energjisë në vendin e tyre (shih Grafikon 3). Për shembull, në Bosnje dhe Hercegovinë, vetëm 8% e të anketuarve e përmendën Kinën si ndikim negativ, pavarësisht përfshirjes së Pekinit në industrinë e qymyrit të këtij vendi. Në Serbi, një përqindje e konsiderueshme prej ish-in pro rritjes së varësisë nga Rusia për energji edhe pse monopoli i Gazprom në tregun e gazit ka penguar diversifikimin e furnizimit (shih Grafikon 4). Dhe në Kosovë, ku nga një investim i një konsorciumi turk në sistemin e energjisë elektrike lindën mjaft polemika, vetëm 3% e të anketuarve e identifikonin Turqinë si ndikim negativ. Këto gjetje nxjerrin në pah një hendek të madh mes mbështetjes dërrmuese të publikut për energjinë e rinovueshme dhe pamundësisë së tij për të kuptuar ndikimin e dëmshëm të aktorëve të jashtëm të investuar në ruajtjen e status quo-së.

Grafiku 3: Ndikimi negativ tek shteti për zgjedhjet e energjisë**Grafiku 4:** Varësia për furnizimin me energji (vendet e Ballkanit Perëndimor)

Në të njëjtën kohë, pretendimi i BE-së se ajo luan një rol pozitiv në sektorin e energjisë nuk është e thënë të pranohet. Një shembull në këtë drejtim është Serbia. Edhe pse BE është donatori më i madh financiar për sa i përket sektorit të energjisë (165 milionë euro si ndihmë e menjëhershme në 2023, përveç më shumë se 1 miliard euro për sektorin që nga viti 2000)⁸, vetëm 28% e të anketuarve serbë argumentuan se vendi i tyre duhet të mbështetet më shumë te BE për sigurinë e furnizimit me energji. Përveç kësaj, 29% besonin se BE ushtron ndikim negativ në zgjedhjet energjetike të Serbisë, krahasuar me vetëm 13% që mendojnë se ky ndikim negativ vjen nga Rusia. Për më tepër, këto pikëpamje pro-ruse i kanë serbët e të gjithë rajonit (shih Grafikon 5).


8 "Projektet e BE-së në Serbi: Energjia", <https://www.euzatebe.rs/en/sectors/energy/about>.

Grafiku 5: Varësia për furnizimin me energji
(serbët në Ballkanin Perëndimor)



Po ashtu, nga sondazhi u evidentua se përkatësisht 49% dhe 44% e të anketuarve nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut besonin se BE po u kërkonte shumë nga vendet e tyre për sa i përket reformave energjetike (krahasuar me 32% dhe 38% që mendonin se këto kërkesa ishin të përshtatshme ose BE po u kërkonte shumë pak). Në Kosovë, pikëpamjet e publikut për këtë çështje ndaheshin pothuajse në mënyrë të barabartë (shih Grafikon 6).

Grafiku 6: Vlerësimi për kërkesat e BE-së për reformimin e sistemit të energjisë në vendet e Ballkanit Perëndimor



Ajo që mund të vihet re është se gjetjet e sondazhi tregojnë se politikat e BE-së nuk kuptohen ose nuk mbështeten tërësisht në të gjithë rajonin. E thënë ndryshe, BE nuk ka arritur të bëjë politikë në rajon në mënyrë të tillë që rekomandimet e saj të pranohen gjerësisht. Praktika e BE-së për të zbatuar prioritetet e politikës së saj energjetike në Ballkanin Perëndimor nuk duket se trajton shqetësimet kryesore politike në rajon, të cilat lidhen me mundësinë për të përballuar kostot e energjisë dhe ndotjes së ajrit. Duke marrë parasysh nivelin e lartë të pasigurisë ekonomike dhe varfërinë energjetike në rajon, BE perceptohet nga shumë të anketuar se kërkon shumë, ndërkohë që ofron ndihmë të pamjaftueshme.

Një pyetje interesante që vlen të hulumtohet edhe më tej është nëse shumë përgjigje për këtë sondazh mund të jenë reflektim i zhgënjimit të popullatës me kërkesat për anëtarësimin në BE. Nëse është kështu, mbështetja publike për reformat e parashikuara nga BE në lidhje me energjinë mund të ndikohet negativisht nga bllokimi i procesi të zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor.

Për ta përmbledhur, ndonëse publiku i Ballkanit Perëndimor mbështet tranzicionin e gjelbër, ai ka një pikëpamje mjaft të paqartë e të deformuar për natyrën e ndikimit të aktorëve të jashtëm në reformat energjetike të vendeve të tyre.

III. Raste studimore

Perceptimet e shtrembëruara të publikut për ndikimin e jashtëm në sektorin e energjisë që u shqyrtuan më sipër nxjerrin në pah një paradoks kritik: mbështetja e fortë e publikut për energjinë e rinovueshme bashkëjeton me nivelin e ulët të njohjes së faktit se aktorët e jashtëm pengojnë tranzicionin drejt energjisë së gjelbër. Kjo kontradiktë ofron bazën për shqyrtimin e tre rasteve studimore: ndikimi rus në Serbi, ndikimi kinez në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ndikimi turk në Kosovë.

Në secilin rast, studiuesit e BiEPAG kryen një punë gjithëpërfshirëse në terren, duke u angazhuar me një numër të madh aktorësh, përfshirë këtu përfaqësues nga industria, shoqëria civile, qeveria dhe organizatat ndërkombëtare, së bashku me anëtarët e komuniteteve të prekura drejtpërsëdrejti nga investimet e huaja në energji. Metodologjia ndryshonte sipas vendit: në Bosnje dhe Hercegovinë studiuesit organizuan një tryezë të rrumbullakët në Tuzla dhe kryen intervista individuale. Në Serbi dhe Kosovë, u përdorën intervista gjysmë të strukturuar për të siguruar marrjen e informacionit të pafiltruar dhe për të arritur tek sa më shumë bashkëbisedues. Këto hulumtime për të dhënat parësore u plotësuan nga kërkime të tjera dhe analiza të dokumenteve të ndryshme. Rezultatet e secilit rast studimor individual u publikuan së fundmi në tre përmbledhje politikash të BiEPAG.⁹ Ky seksion fokusohet në një analizë më të thellë të çështjeve dhe paraqet disa gjetje krahasuese nga studimet e rasteve, të cilat mund të përmblihen në tre argumente bazë.

3.1 Elitat vendore si rojtarë

Në të tre rastet studimore, roli i elitave lokale politike dhe i biznesit del se është i një rëndësie të jashtëzakonshme për zbutjen e ndikimit të huaj. Këto elita mund të përfitojnë nga marrëdhëniet e fshehta të biznesit dhe t'i japin përparësi përfitimeve ekonomike në kurriz të qëndrueshmërisë afatgjate. Bashkëpunimi mes investitorëve të huaj dhe elitave vendase bën të mundur që ndikimi i huaj të vazhdojë në sektorin energjetik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke formësuar kështu dinamikën gjeopolitike të tranzicionit drejt energjisë së gjelbër.

Kjo evidentohet më së qarti në Bosnje Hercegovinë, ku investimet kineze gjetën terren të përshtatshëm falë udhëheqësve vendas që i dhanë përparësi

⁹ Ilić, Vujo, "Dilema energjetike e Serbisë: Hulumtimi i tensioneve gjeopolitike, pronësia ruse dhe rruga drejt tranzicionit të rinovueshëm", Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë', tetor 2023. <https://biepag.eu/publication/serbias-energy-dilemma-navigating-geopolitical-tensions-russian-ownership-and-the-path-to-renewable-transition/>; Djolai, Marika dhe Stratulat, Corina, "Gjeopolitika fillon që në shtëpi: Roli i aktorëve të huaj në sektorin energjetik të Bosnje dhe Hercegovinës", Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë', tetor 2023. <https://biepag.eu/publication/geopoliticsbegins-at-home-foreigns-actors-role-in-bosnia-and-herzegovinas-energy-sector/>; Emini, Donika, "Tranzicioni i energjisë në Kosovë: Mes privatizimit dhe liberalizimit të tregut", Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë', nëntor 2023 (së shpejti).

përfitimeve ekonomike afatshkurtra në dëm të mirëqenies mjedisore dhe sociale. Ndërmarrjet shtetërore kineze shpesh përfshihen në projekte me energji që përftohet nga qymyri në bashkëpunim me kompani vendase, duke anashkaluar proceset e kontrollit dhe miratimit. Ekspertët e intervistuar pohuan se këto kontrata janë të integruara në rrjete klienteliste dhe të orkestruara nga partitë politike për të financuar interesat e tyre personale. Këta aktorë vendas kanë bërë të mundur krijimin e një mjedisi mundësues që aktorët e huaj të shfrytëzojnë burimet e bollshme natyrore të vendit.¹⁰

Po ashtu, në Serbi, dominimi rus është lehtësuar përmes elitave lokale të përfshira në praktikatat e marrjes së rryshfeteve në sektorin e energjisë.¹¹ Ndonëse situata në sektorin e naftës nuk është aq e mjerueshme sa në sektorin e gazit – edhe pse të dy kontrollohen tërësisht nga pronarë rusë – panorama e përgjithshme karakterizohet nga mungesa e kontrollit rregullator dhe sundimi i influencës politike.¹² Edhe Kosova sheh se investimet turke ndërmjetësohen përmes elitave politike në vend dhe nga biznesi. Përqendrimi i pronësisë në duart e një konsorciumi turk krijon shqetësime për konflikte interesi dhe pengon krijimin e konkurrencës në tregun energjetik.¹³

Roli rojtar i udhëheqjes lokale ndikon dhe manifestohet nëpërmjet perceptimeve të publikut në lidhje me aktorët e jashtëm. Nëpërmjet medias, pushtetarët vendas kanë ndërtuar një imazh pozitiv të disa aktorëve të fuqishëm të tretë që janë me rëndësi për fshehjen e interesave kryesore të elitave vendase dhe të huaja dhe, si rrjedhojë, për fshehjen nga syri kontrollues i publikut i marrëveshjeve të dëmshme për mjedisin. Në Ballkanin Perëndimor, njerëzit informohen kryesisht nga mediat lokale, ku 71% e të anketuarve në sondazhin tonë përmendën TV si burimin e tyre kryesor të informacionit. Si rezultat, gjetjet tona tregojnë se elitat lokale dhe mediat e tyre që janë miqësore me regjimin kanë luajtur një rol kryesor në formësimin e perceptimeve të publikut për palët e treta. Ato ndikojnë shumë në propagandën e tyre dhe kufizojnë marrjen e informacionit që mund të sfidojë status quo-në ekzistuese.

3.2 Ndikimi i aktorëve të jashtëm në sektorin e energjisë nuk është i njëjtë

Lojtarët e jashtëm gjeopolitikë ushtrojnë ndikim në forma të ndryshme. Roli i tyre nuk është i njëjtë. Disa aktorë të huaj me të vërtetë luajnë një rol kryesisht negativ, siç tregohet në rastin e Bosnjë Hercegovinës, ku nga projektet kineze janë ngritur shqetësime për çështjet që lidhen me qeverisjen dhe ndikimin në mjedis. Megjithatë, edhe në atë rast, hulumtimi zbulon se aktorët vendas janë vendimtarë. Pa këta aktorë, ndikimi i huaj do të ishte shumë më pak i dëmshëm.

¹⁰ Djolai, Marika dhe Stratulat, Corina, "Gjeopolitika fillon që në shtëpi", 2023.

¹¹ Prelec, Tena. "Rrethi vicioz i kapitalit gjërryes, tendencave autoritare dhe kapjes së shtetit në Ballkanin Perëndimor." *Revista e Sigurisë Rajonale* 15, Nr. 2 (2020): 167-98

¹² Ilić, Vujo, "Dilema energjetike e Serbisë", 2023.

¹³ Emini, Donika, "Tranzicioni i energjisë i Kosovës", 2023.

Për më tepër, është e rëndësishme të pranohet se disa aktorë sillen ndryshe në sektorë të ndryshëm. Rasti i Serbisë tregon se pronarët rusë shfaqin një model të veçantë sjelljeje në sektorët e naftës dhe gazit. Në të parën, fokusi është kryesisht te fitimi dhe modernizimi me ndërhyrje të kufizuar në konkurrencë. Si për krahasim, në sektorin e gazit, Rusia mban peng furnizimin me gaz, rezervat dhe tubacionet e gazit, duke penguar kështu reformën dhe përafrimin e këtij sektori me standardet e BE-së.

Së fundi, rasti studimor i Kosovës tregon se përfshirja e aktorëve të jashtëm ndonjëherë mund të sjellë përmirësime, por që, gjithsesi, është me rëndësi vendimtare të ushtrohet mbikëqyrja e duhur. Privatizimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë nga konsorciumi Limak-Calik ka përmirësuar shpërndarjen e energjisë elektrike, duke reduktuar ndërprerjet e furnizimit dhe duke rritur sigurinë energjetike, ndërkohë që ende ngre pyetje në lidhje me praktikën e prokurimit, transparencën e procedurave dhe ndikimin përfundimtar në xhepat e publikut.

3.3 Bllokimet e tranzicionit dhe korrupsioni punojnë së bashku – por edhe paraja e pistë mund të jetë “e gjelbër”

Rastet studimore kanë treguar se pengesat ndaj tranzicionit të energjisë dhe ndikimi i korrupsionit ndonjëherë janë në unison me njëri tjetrin. Megjithatë, do të ishte gabim të supozohej se aktorët e jashtëm joperëndimorë janë të fokusuar vetëm në lëndët djegëse fosile me emetim të lartë të karbonit. Këta aktorë po investojnë gjithnjë e më shumë në burimet e rinovueshme. Le të shohim, për shembull, përpjekjet e Gazpromneft për ta paraqitur veten si një kompani “më e gjelbër” ose ethet e Kinës për metale të rralla të nëntokës në të gjithë botën.

Po ashtu, praktikën e fshehta që shpesh karakterizojnë investimet në energji në rajon nuk kufizohen vetëm te përpjekjet ndotëse: korrupsioni mund të shfaqet edhe në formën ‘të gjelbra’. Teksa fitimet që do të vilen nga projektet e gjelbra rriten për nga madhësia, do të shohim një rritje të numrit të aktorëve me lidhje politike që përpjekin të nxjerrin fitime prej tyre. Në fakt, kjo ka ndodhur në të kaluarën – me efekte të pasigurta në mjedis (p.sh. përmes tarifave të garantuara nga shteti, mekanizmat e krijuar për të përsheptuar investimet e rinovueshme, për mini hidrocentralet në Serbi¹⁴). Prandaj, është me rëndësi parësore që projektet të mos ‘gjelbërohen’ për t’i shpëtuar kështu kontrollit dhe monitorimit.

Për ta përmbledhur, është me rëndësi të madhe të kuptohen sa më mirë rolet e aktorëve të jashtëm gjeopolitikë në sektorin e energjisë në Ballkanin Perëndimor për të kuptuar kështu gjeopolitikën e shumëanshme të tranzicionit drejt energjisë së gjelbër dhe për të nisur me hartimin e masave të përshtatshme të politikave për një tranzicion të qëndrueshëm drejt energjisë së gjelbër për rajonin.

¹⁴ Dorđević, D., “Pjesa më e madhe e parave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë të Serbisë (EPS) dhe për kompanitë e lidhura sërish me Nikola Petrović”, Qendra për Gazetarinë Investigative të Serbisë, 19 prill 2019, <https://www.cins.rs/en/most-money-for-eps-and-companies-connected-to-nikola-petrovic-again/>.

Rekomandime

Ashtu siç bëhet e qartë nga ky hulumtim për panoramën e ndikimeve të aktorëve të jashtëm në tranzicionin energjetik në Ballkanin Perëndimor, për trajtimin e këtyre sfidave të gjithanshme kërkohet një strategji gjithëpërfshirëse. Teksa dalin në pah një sërë çështjesh të mëdha që kanë nevojë të analizohen më tej, gjetjet tona evidentojnë rolin kryesor të elitave lokale, natyrën e ndryshme të ndërhyrjeve të jashtme dhe ndërveprimin mes pengesave të tranzicionit dhe korrupsionit. Duke pasur parasysh këto njohuri, me poshtë jepen rekomandimeve për BE-në për të kontribuar në mënyrë proaktive për një tranzicion të qëndrueshëm dhe të drejtë të energjisë së gjelbër në rajon.

BE duhet:

- > Të ndërmarrë një fushatë të diplomacisë publike për të shpjeguar avantazhet e tranzicionit drejt sistemit energjetik të gjelbër. Kjo fushatë duhet të ketë në fokus audiencat kryesore si opinionistët dhe banorët e qendrave urbane, të cilët me shumë gjasa duhet të jenë të shqetësuar për cilësinë e dobët të ajrit. Fushata duhet të mbështetet më shumë në platformat online sesa në mediat tradicionale, të cilat ka të ngjarë të kapen nga elitat që janë kundër reformës.
- > Të fuqizojë aktorët organizatave të shoqërisë civile në nivel vendor që punojnë për tranzicionin drejt energjisë së gjelbër në rajon duke u ofruar atyre mbështetje më të madhe financiare dhe më shumë konsultime nivel sistemi.
- > Të nxisë me më shumë vendosmëri diversifikimin e burimeve të energjisë për të reduktuar varësinë nga qymyri, veçanërisht duke promovuar burimet e rinovueshme, dhe të shmangë vonesat në kalimin drejt Skemës së Tregtimit të Emetimeve, meqenëse qymyri duhet të dalë jashtë tregut.
- > Të ofrojë stimuj financiarë për të mbështetur liberalizimin e tregut krahas kalimit të burimeve të rinovueshme, duke nxitur konkurrencën dhe duke pakësuar monopolet. Fondet duhet të ndahen për të kompensuar grupet vulnerabël që mund të ndikohen negativisht nga liberalizimi i tregut.
- > Të kërkojë më shumë transparencë dhe rregullim më të mirë të investimeve të huaja, veçanërisht në përhapjen e burimeve të rinovueshme. Një prioritet kyç duhet të jetë lufta kundër praktikave korruptive që lidhen me investimet e gjelbra, të tilla si dhënia e privilegjeve miqve në ndarjen dhe dhënien e lejeve, licencave, lidhjeve në rrjet dhe përfitimeve të tjera që ofrohen nga qeveria ose entet rregullatore.
- > Të nxisë bashkëpunimin rajonal (në një shkallë më të gjerë, d.m.th., mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe fqinjëve të tyre që janë pjesë e BE-së) në ndërlidhjen e rrjetit dhe për investimet ndërkufitare në burimet e rinovueshme. Problemi i ndërprerjeve të furnizimit me energji mund të zgjidhet në një shkallë më të gjerë rajonale sesa në nivel vendi.
- > Të ofrojë mbështetje më të posaçme për investime në burimet e energjisë së rinovueshme në rajon.

Rreth neth

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Koordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihić, Richard Grieveson, Donika Emimi, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent koordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

<https://biepag.eu>

Kontakt: MILENA STEFANOVIĆ, Drejtore Programi,
milena.stefanovic@balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritimit në BE. Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

www.balkanfund.org

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive,
aleksandra.tomanic@balkanfund.org

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore

<http://csees.uni-graz.at/>

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER,
Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore,
florian.bieber@uni-graz.at

Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Evropian për Klimën. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim është e autorit(ve). Fondacioni Evropian i Klimës nuk mund të jetë përgjegjës për përdorimet që mund t'i bëhen informacioneve që jepen ose shprehen në këtë studim. Fondi Evropian për Ballkanin 2023.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

